



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 928/2 Prot.

Tiranë, më 25/7 /2017

REKOMANDIM

Nr. 35 datë 25/7 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Ndhma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.163, datë 15.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Ndhma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Ndhma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.163, datë 15.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Ndhma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, është subjekt juridik me NIPT: J62214001L, me aktivitet shërbimin social të përkujdesit për fëmijët jetimë dhe atyre me probleme sociale, për moshat 14-18 vjeç. Ky kontrollues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave "punëmarrës" e "fëmijë".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi "Ndhma e Weilheimit për Shqipërinë", Elbasan nuk ka kryer detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.

Konstatimi i pikës 1 të këtij procesverbal, përbën shkelje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të

përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi “*Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë*”, Elbasan nuk disponon rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konstatimi i pikës 2 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar:

“1.Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2.Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.

3. Kontrolluesi “*Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë*”, Elbasan në arkivën e tij, ka të grumbulluara dosje të cilat datojnë që në fillimet e veprimtarisë së tij, viti 1992. Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 5, germa “d” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar:

“1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.

4. Kontrolluesi “*Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë*”, Elbasan nuk aplikon “*Deklaratë Konfidencialiteti*” me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Ky detyrim duhet të materializohet me standardin e Deklaratës së Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit, ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, masat për shpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimin e punëdhënësit.**

Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar:

“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, të realizojë detyrimin për njoftim dhe në vazhdimësi detyrimin mbi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, të hartojë dhe përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".
3. Në zbatim të nenit 5, germa "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, të parashikojë në rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale", afatet ligjore të ruajtjes së të dhënave personale (dosjet) e përfituesve.
4. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, të marrë masa për të pajisur me Deklarata Konfidencialiteti të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës pranë këtij kontrolluesi, sipas standardit të parashikuar në Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit.
5. Kontrolluesi "Ndihma e Weilheimit për Shqipërinë" Elbasan, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 3, dhe 4 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 60 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 20/7/2017

